



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE

Tiranë më 27.01.2020
(Dokument parlamentar)

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN
“PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT TË GJASHTË SHITESË TË MARRËVESHJES
PËR FORCËN SHUMËKOMBËSHE TË PAQES NË EVROPËN JUGLINDORE”

- HYRJE

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, bazuar në nenet 32-36 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e datës 27.01.2019, mori në shqyrtim projektligjin “ Për ratifikimin e protokollit të gjashtë shtesë të marrëveshjes për forcën shumëkombëshe të paqes në Evropën Juglindore ”

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relator deputeti Xhemal Qefalia.

Për të bërë prezantimin e marrëveshjes në komision morën pjesë përfaqësues Zëvendësministri i Mbrojtjes z. Petro Koçi dhe përfaqësues nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

- BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të nenit 81, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës si dhe të nenit 17 të ligjit nr.43/2016 “ Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë ”dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

- QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Qëllimi i këtij projektligji është ratifikimi i protokollit të gjashtë shtesë të marrëveshjes për Forcën Shumëkombëshe të Paqes në Evropën Juglindore. Synimi kryesor është rritja e fleksibilitetit të ndërveprimit të brigades SEEBRIG-së me njësitë e tjera në operacione të NATO-s, BE-së dhe OKB-së, si dhe një rritje e efikasitetit të funksionimit bazë të forcës.

Ky protokoll ka për synim përmirësimin e marrëveshjes bazë, pasi është gjykuar se nevojitet më shumë fleksibilitet në vendimet që merren, për sa i përket mënyrës se si funksionon Forca Shumëkombëshe e Evropës Juglindore (MPFSEE) dhe brigada e saj SEEBRIG.

Forca Paqeruajtëse Shumëkombëshe e Evropës Juglindore (MPFSEE) u krijua me qëllimin për të kontribuar në sigurimin e stabilitetit rajonal dhe për të kultivuar marrëdhënie të fqinjësisë së mirë ndërmjet vendeve të Evropës Juglindore.

Krijimi i kësaj Force, në nivelin fillestar të një brigade shumëkombëshe (SEEBRIG), u vlerësua si një mundësi e mirë përgatitjeje e personelit të Forcave të Armatosura të secilit shtet, për të qenë të gatshëm për të vepruar më pas, në kuadër të misioneve të NATO-s apo OKB-së.

Për të zyrtarizuar këtë iniciativë, në Shkup të Maqedonisë, në datën 26 shtator 1998, u nënshkrua prej ministrave të Mbrojtjes së shtatë vendeve të Evropës marrëveshja për krijimin e Forcës Shumëkombëshe të Evropës Juglindore dhe protokollit i parë shtesë i saj. Vendet nënshkruese të kësaj marrëveshjeje janë Shqipëria, Italia, Turqia, Greqia, Rumania, Bullgaria dhe Maqedonia. Marrëveshja u ratifikua nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr.8544, datë 4.11.1999.

Me kalimin e viteve, modernizimin e kapaciteteve, ndërveprimin në rritje me NATO-n, por edhe vendimeve që janë marrë në kuadër të iniciativës të Ministerialit të Mbrojtjes së Evropës Juglindore (SEDM *Process*), kanë ndodhur shumë ndryshime edhe në mënyrën e funksionimit dhe strukturën e MPFSEE-së. Këto ndryshime janë dashur të pasqyrohen pa dyshim në marrëveshjen bazë të krijimit të forcës dhe për këtë janë nevojitur të hartohen dhe të hyjnë në fuqi, përveç protokollit të parë, edhe katër protokolle të tjera dhe përkatësisht:

- Protokollit i dytë shtesë, i nënshkruar në Bukuresht, më 30 nëntor 1999, ratifikuar me ligjin nr.8640, datë 13.7.2000;
- Protokollit i tretë shtesë, i nënshkruar në Athinë, më 21 qershor 2000, ratifikuar me ligjin nr.8816, datë 20.09.2001;
- Protokollit i katërt shtesë, i nënshkruar në Romë, më 11 dhjetor 2002, ratifikuar me ligjin nr.9037, datë 27.3.2003;
- Protokollit i pestë shtesë, i nënshkruar në Sofje, më 21 tetor 2009, ratifikuar me ligjin nr.10172, datë 29.4.2010.

- DIKSUTIME NË KOMISION

Gjatë diskutimeve në komision, përfaqësuesi i Zëvendësministrit i Mbrojtjes Z.Petro Koçi në fjalën e tij theksoi rëndësinë e këtij protokollit, synimi kryesor i të cilit është rritja e fleksibilitetit të ndërveprimit të brigades SEEBRIG-së me njësitë e tjera në operacione të NATO-s, BE-së dhe OKB-së, si dhe një rritje e efikasitetit të funksionimit bazë të forcës.

Z.Koçi u shpreh se ndryshimet e marrëveshjes nuk prekin thelbin e saj, pra parimet mbi të cilat funksionon Forca Shumëkombëshe e Evropës Juglindore MPFSEE-ja dhe qëllimi për të cilën ajo u krijua.

Gjatë fjaës së tij ai sqaroi se vendet pjesëmarrëse në këtë marrëveshje janë Shqipëria, Italia, Turqia, Greqia, Rumania, Bullgaria dhe Maqedonia e Veriut. Me përjashtim të Maqedonisë së Veriut, e cila është në përfundim të procesit të ratifikimit të marrëveshjes për anëtarësim në NATO, të gjitha vendet janë anëtare të NATO-s. Kur kjo është krijuar, ka qenë viti 1998, dhe disa prej këtyre vendeve që janë pjesë e marrëveshjes, përfshi edhe Shqipërinë, që nuk kanë qenë pjesë e NATO-s.

Gjatë relatimit të tij Z.Koçi theksoi se edhe pse për shumë vite, tashmë vendet kontribuese në MPFSEE kanë një bashkëpunim mjaft të mirë, është parë i nevojshëm sërish amendimi i marrëveshjes bazë me një protokoll të gjashtë. Drafti është rezultat i bashkëpunimit të ekspertëve ligjorë të vendeve pale.

Në vijim ai ju përgjigj pyetjeve të deputetëve ku sqaroi se :

Shqipëria paguan një kontribut vjetor për të qënë pjesë e Forcës Shumëkombëshe të Evropës Juglindore MPFSEE, ndërkohë janë tre ushtarakë të përhershëm atje dhe të gjitha këto janë në ngarkesë financiare të Republikës së Shqipërisë,

Lidhur me pyetjen e drejtuar nga kryetarja e komisionit, z. Koçi sqaroi se brenda procesit të SEDM-it brigada SEEBRIG është, mekanizmi kryesor praktik që kultivon frymën e bashkëpunimit ndërmjet forcave ushtarake që janë pjesë e kësaj force shumëkombëshe. Fryma aty kultivon bashkëpunimin mes vendeve të ndryshme në një rajon, i cili, ka prodhuar shumë histori konfliktesh. Ky është një nga mekanizmat që shikon drejt së ardhmes, prandaj quhet Forcë Shumëkombëshe e Paqes, dhe që eksploron gjithnjë e më tej fushat e bashkëpunimit, por edhe në nivel ushtarak në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes në shërbim të paqes dhe stabilitetit në rajon. Brigada SEEBRIG ka një kalendar shumë të ngjeshur veprimtarish brenda një viti, i cili aprovet në ministerial. Ata, së bashku, zhvillojnë vizita, takime në vendet e ndryshme, që janë anëtare të SEDM-it, dhe marrin pjesë si shtab edhe në stërvitje dhe në veprimtari ushtarake të përbashkëta, të cilat mund të jenë pjesë e SEDM-it, por edhe jo pjesë e tij. Komandantët e brigadës SEEBRIG ndryshohen me rotacion. Edhe Shqipëria ka pasur, në vitet 2007-2009, ku komandant i kësaj brigade ka qenë Gjeneral Dushku.

Pas relatimit edhe të z.Qefalia u vlerësua kjo nisëm, e cila i shërben ndërveprimit të brigades SEEBRIG-së me njësitë e tjera në operacione të NATO-s, BE-së dhe OKB-së.

Në përfundim të diskutimeve, përfaqësuesit e Ministrisë së Mbrojtjes sqaruan se miratimi përfundimtar i marrëveshjes, i cili do të bëhet nëpërmjet ratifikimit nga Kuvendi i Republikës së

Shqipërisë, nuk do të ketë asnjë efekt shtesë në buxhetin e shtetit, përveç detyrimeve të ndërmarra që në anëtarësimin fillestar në vitin 2000.

- PËRFUNDIME

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje e miratoi atë duke vlerësuar se:

Në aspektin ligjor, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

RELATOR

Xhemal Qefalia
(FELAJ)

KRYETARE

Ermonela VALIKAJ